

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
(me raportin e Audituesve të pavarur)

Përmbajtja

	<u>Faqe</u>
Raporti i Audituesve të pavarur	i-iii
Pasqyra e pozicionit financiar	1
Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	2
Pasqyra e ndryshimeve në kapital	3
Pasqyra e flukseve monetare	4
Shënime shpjeguese mbi pasqyrat financiare	5-36



KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri
Telefon +355(4)2274 524
al-office@kpmg.com
kpmg.com/al

Raporti i Audituesve të Pavarur

Për ortakët e Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, si dhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Shoqërisë më 31 dhjetor 2018, si dhe të performancës së saj financiare dhe flukseve të saj të parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit tonë ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesve për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi i BSNEPK) dhe me Kodin e Etikës të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Shqipëri (Kodi i IEKA-s), si dhe me kërkesat etike të Ligjit Nr. 10091, datë 5 mars 2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor, dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa si dhe me Kodin e BSNEPK dhe Kodin e IEKA-s.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera

Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Informacionet e tjera përfshijnë informacionin që jepet në Raportin e Drejtimit të 2018 për ortakët, por nuk përfshijnë pasqyrat financiare dhe raportin tonë të audituesve mbi këto pasqyra.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk do të shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin e pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera, të identifikuar më lart kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë mospërputhje materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Pasi të lexojmë Raportin e Drejtimit, nëse arrijmë në përfundimin se në këtë raport ka një anomali materiale, atëherë ne duhet të komunikojmë për këtë çështje me drejtimin. Ne nuk kemi asgjë për të raportuar për këto informacione.

Përgjegjësitë e Drejtimit në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, për të dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe për të përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likuidojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Përgjegjësitë e Audituesve për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me drejtimin, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.



Fatos Beqja
Auditues Ligjor
KPMG Albania Shpk
Blvd "Dëshmorët e Kombit"
Kullat Binjake, Kulla 1, Kati 13
Tiranë, Shqipëri

Tirana, 28 mars 2019

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Pasqyra e pozicionit financiar

(Shumat në Lek)

	Shënimi	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Aktivët			
Aktive afatgjata materiale	8	1,218,852,871	1,139,380,345
Investime	9	23,000,000	23,000,000
Huadhënie	10	185,130,000	-
Aktive tatimore të shtyra	29	1,286,424	1,722,006
Totali i aktiveve afatgjata		1,428,269,295	1,164,102,351
Inventarë	11	208,053,099	211,134,766
Kërkesa për arkëtim nga klientët	12	24,407,450	23,706,074
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura	13	57,004,138	85,699,670
Aktive të tjera afatshkurtra	14	58,245,642	22,885,558
Depozita me afat	15	458,216,840	557,800,000
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to	16	176,163,265	298,627,430
Totali i aktiveve afatshkurtra		982,090,434	1,199,853,498
Totali i aktiveve		2,410,359,729	2,363,955,849
Detyrimet dhe kapitali			
Kapitali i paguar	17	1,493,040,000	1,493,040,000
Rezerva ligjore	18	29,987,807	29,987,807
Rezerva të tjera	19	41,264,800	41,264,800
Fitimi i mbartur		486,763,484	407,711,488
Totali i kapitalit		2,051,056,091	1,972,004,095
Detyrime tatimore të shtyra	29	28,565,178	27,868,467
Totali i detyrimeve afatgjata		28,565,178	27,868,467
Detyrime ndaj palëve të lidhura	20	14,251,691	20,559,438
Detyrime ndaj furnitorëve	21	145,983,667	182,243,834
Tatim fitimi i pagueshëm	29	7,874,911	10,334,150
Detyrime të tjera	22	162,628,191	150,945,865
Totali i detyrimeve afatshkurtra		330,738,460	364,083,287
Totali i detyrimeve		359,303,638	391,951,754
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		2,410,359,729	2,363,955,849

Shënimet shpjeguese, në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Pasqyra e fitim ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse

(Shumat në Lek)

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2018	2017
Të ardhurat nga shitjet	23	3,667,555,574	3,440,678,334
Kostoja e mallrave të shitura	24	(2,270,875,484)	(2,190,922,951)
Fitimi bruto		1,396,680,090	1,249,755,383
Të ardhura të tjera	25	220,508,758	208,725,206
Shpenzime personeli	26	(433,195,432)	(414,546,338)
Amortizimi	8	(70,885,008)	(64,110,523)
Shpenzime të tjera operative	27	(502,999,347)	(513,158,194)
		(786,571,029)	(783,089,849)
Rezultati nga veprimtaritë shfrytëzuese		610,109,061	466,665,534
Shpenzime financiare		(39,533,981)	(8,328,942)
Të ardhura financiare		4,695,609	3,780,077
Shpenzime financiare neto	28	(34,838,372)	(4,548,865)
Fitimi para tatimit		575,270,689	462,116,669
Tatimi mbi fitimin	29	(88,507,205)	(71,282,473)
Fitimi i vitit		486,763,484	390,834,196
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse			
Të tjera që nuk do të klasifikohen në fitim ose humbje		-	-
Investime në instrumente kapitali me VDATGJ - ndryshimi neto në vlerën e drejtë	9	-	-
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga tatimi mbi fitimin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit		486,763,484	390,834,196

Shënimet shpjeguese, në faqet 5 deri 36, janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Pasqyra e ndryshimeve në kapital

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018

(Shumat në Lek)

	Kapitali i paguar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitimi i mbartur	Totali
Gjendja më 1 janar 2017	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	307,573,626	1,871,866,233
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					
Fitimi i vitit	-	-	-	390,834,196	390,834,196
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	390,834,196	390,834,196
Transaksione me ortakët e Shoqërisë					
Kontributet dhe shpërndarjet					
Dividendë	-	-	-	(290,696,334)	(290,696,334)
Totali i transaksioneve me ortakët e Shoqërisë	-	-	-	(290,696,334)	(290,696,334)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	407,711,488	1,972,004,095
Gjendja më 1 janar 2018	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	407,711,488	1,972,004,095
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse					
Fitimi i vitit	-	-	-	486,763,484	486,763,484
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	-	-	-	486,763,484	486,763,484
Transaksione me ortakët e Shoqërisë					
Kontributet dhe shpërndarjet					
Dividendë	-	-	-	(407,711,488)	(407,711,488)
Totali i transaksioneve me ortakët e Shoqërisë	-	-	-	(407,711,488)	(407,711,488)
Gjendja më 31 dhjetor 2018	1,493,040,000	29,987,807	41,264,800	486,763,484	2,051,056,091

Shënimet shpjeguese, në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Pasqyra e flukseve monetare

(Shumat në Lek)

	Shënimi	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor	
		2018	2017
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit			
Fitimi i vitit:		486,763,484	390,834,196
<i>Rregullime për:</i>			
Amortizimin	8	142,943,934	131,665,495
Humbjen neto nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe shitja e aktiveve afatgjata materiale	8	10,234,766	12,771,038
Nxjerrje jashtë përdorimi e inventarëve	24	19,581,467	13,509,915
Kërkesa për arkëtim nga klientët të fshira	12	4,399,933	-
Detyrime ndaj furnitorëve të fshira	21	(3,182,901)	-
Të ardhura nga interesat	28	(3,810,009)	(3,391,739)
Të ardhura nga dividendët	28	(885,600)	(388,338)
Shpenzime interesi	28	-	254,848
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	29	88,507,205	71,282,473
		744,552,279	616,537,888
<i>Ndryshime në:</i>			
Inventarë		(16,499,800)	(67,074,028)
Depozita me afat		99,583,160	(16,880,000)
Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura		28,695,532	(14,365,711)
Kërkesa për arkëtim nga klientët		(5,101,309)	17,386,860
Aktive të tjera afatshkurtra		(33,685,938)	9,723,950
Detyrime ndaj palëve të lidhura		(6,307,747)	10,767,020
Detyrime ndaj furnitorëve		(33,077,266)	79,255,926
Detyrime të tjera		11,682,326	10,039,421
Mjete monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit		789,841,237	645,391,326
Interesa të arkëtuara		2,135,863	3,003,285
Interesa të paguar		-	(254,848)
Tatimi mbi fitimin i paguar		(89,834,151)	(61,257,314)
Mjete monetare neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit		702,142,949	586,882,449
Mjete monetare nga veprimtaritë investuese			
Dividendë të arkëtuara		885,600	388,338
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	8	(235,636,514)	(207,102,453)
Të hyra nga shitjet e pajisjeve dhe automjeteve		2,985,288	9,103,679
Huadhënie		(185,130,000)	-
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë investuese		(416,895,626)	(197,610,436)
Mjete monetare nga veprimtaritë e financimit			
Dividendë të paguar	17	(407,711,488)	(290,696,334)
Mjete monetare neto përdorur në veprimtaritë e financimit		(407,711,488)	(290,696,334)
(Pakësimi)/rritja neto e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve me to		(122,464,165)	98,575,679
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 1 janar	16	298,627,430	200,051,751
Mjete monetare dhe ekuivalentë me to më 31 dhjetor	16	176,163,265	298,627,430

Shënimet shpjeguese, në faqet 5 deri 36 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

Këto pasqyra financiare të Coca-Cola Bottling Shqipëria u aprovuan nga Këshilli i Administrimit më 19 mars 2019 dhe u firmosën në emër të tyre nga Drejtuesit e Shoqërisë më 28 mars 2019 nga:

Ervina Kuta
Drejtor Financiar dhe Administrativ

Luigi Verardo
Drejtor i Përgjithshëm



Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

1. Entiteti raportues

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk ("Shoqëria") është themeluar në qershor të 1993, si një shoqëri me kapital të përbashkët ndërmjet Aziende Commerciali Industriali e Servizi S.r.l. ("ACIES"), shoqëria mëmë përfundimtare e cila është një shoqëri italiane me zyrat qendrore në Bolonja, Itali; The Coca-Cola Export Corporation ("TCCEC"), e themeluar në shtetin e Delaware, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe Invest P.F., një shoqëri shqiptare me kapital shtetëror me zyrat qendrore në Tiranë, Shqipëri dhe e themeluar në Shqipëri si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shoqëria është angazhuar në prodhimin, mbushjen dhe shitjen e të gjitha produkteve të markës Coca-Cola në Shqipëri, sipas kontratës së Shoqërisë me The Coca-Cola Company (TCCC) dhe The Coca-Cola Export Corporation.

Ortakët e shoqërisë dhe pjesëmarrjet e tyre në kapital janë si më poshtë:

Ortakët	Në %	
	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
SIBEG Srl	74.69	74.69
TCCEC	22.65	22.65
INVEST P.F.	2.66	2.66
	100.00	100.00

Gjatë vitit 2018 nuk ka patur ndryshime në ortakët e Shoqërisë dhe në kuotat e tyre respektive.

Shoqëria është vendosur në Kashar, 5 km nga Tirana me 347 punonjës më 31 dhjetor 2018 përfshirë punonjësit sezonalë (2017: 318 punonjës).

2. Bazat e kontabilitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Politikat kontabël kryesore të Shoqërisë përfshihen në Shënimin 6.

Këto janë pasqyrat e para financiare vjetore në të cilat aplikohen SNRF 15 Të ardhurat nga Kontratat me Klientët dhe SNRF 9 Instrumentet Financiare. Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël janë të përshkruara në Shënimin 5.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë paraqitur në Lek, e cila është monedha funksionale për Shoqërinë.

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi i Shoqërisë të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga çmuarjet.

Çmuarjet dhe supozimet përkatëse rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e çmuarjeve njihen në mënyrë prospektive.

A. Gjykime

Informacioni për gjykimet e bëra në aplikimin e politikave kontabël që kane efektet më të rëndësishme në vlerat e njohura në pasqyrat financiare janë të përfshira në shënimin e mëposhtëm:

- Shënimi 6(i)– njohja e të ardhurave: nëse të ardhurat njihen përgjatë kohës apo në një moment të caktuar në kohë;
- Shënimi 9- klasifikimi i investimeve në instrumente të kapitalit të matura me "VDATGJ"

B. Supozimet dhe vlerësimi i pasigurive

Informacioni mbi vlerësimin e pasigurive të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve të paraqitura në pasqyrat financiare përshkruhet në paragrafët në vijim:

- Shënimi 6 (i) - njohja e të ardhurave: vlerësimi i kthimeve të pritshme dhe zbritjeve;
- Shënimi 29- llogaritja e tatimit mbi të ardhurat dhe aktiveve tatimore të shtyra: disponueshmëria e fitimit të tatuueshëm në të ardhmen, ndaj të cilit mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme të zbritshme dhe humbjet tatimore të mbartura;
- Shënimi 30(b)(ii) – vlerësimi i zbritjes për humbjet e pritshme nga kredia ("HPK") për kërkesat për arkëtim nga klientët supozimet kryesore në përcaktimin e normës së ponderuar të humbjeve mesatare;
- Shënimi 9 - përcaktimi i vlerës së mbetur të instrumenteve financiare me inpute të konsiderueshme të paverifikueshme.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

4. Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve (vazhdim)

B. Supozimet dhe vlerësimi i pasigurive (vazhdim)

Matja e vlerës së drejtë

Politika kontabël dhe shënimet shpjeguese mbi investimet kapitale kërkojnë matjen e vlerës së drejtë. Në matjen e vlerës së drejtë, Shoqëria përdor të dhëna të verifikueshme të tregut sa më shumë të jetë e mundur. Vlerat e drejta kategorizohen në nivele të ndryshme të hierarkisë së vlerës së drejtë bazuar në të dhënat e përdorura në teknikat e vlerësimit si në vijim:

- Niveli 1: Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregje aktive për aktive të ngjashme;
- Niveli 2: Të dhëna të ndryshme nga çmimet e kuotuar të përfshira në Nivelin 1, të cilat janë të verifikueshme për aktivin, ose direkt (p.sh çmimet) ose indirekt (p.sh rrjedhin prej çmimeve);
- Niveli 3: Të dhënat për aktivet të cilat nuk bazohen në të dhëna të verifikueshme tregu (të dhëna të pa-verifikueshme).

Nëse të dhënat e përdorura për të matur vlerën e drejtë të një aktivi ose të një detyrimi përfshihen në nivele të ndryshme të hierarkisë të vlerës së drejtë, atëherë matja e vlerës së drejtë kategorizohet e gjitha në të njëjtin nivel të hierarkisë të vlerës së drejtë me nivelin më të ulët të të dhënave të rëndësishme për të gjithë vlerësimin.

Shoqëria njeh transfertat midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese gjatë së cilës ka ndodhur ndryshimi.

5. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël

Shoqëria ka nisur zbatimin e SNRF 15 (shih A) dhe SNRF 9 (shih B) nga 1 janar 2018. Një numër standardesh të tjera të reja janë gjithashtu efektive nga 1 janar 2018 por nuk kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

Për shkak të metodave të tranzicionit të zgjedhura nga Shoqëria për të aplikuar këto standarde, informacioni krahasues në këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja.

Aplikimi fillestar i këtyre standardeve nuk ka rezultuar në rregullime dhe është limituar në kërkesa për informacione shpjeguese shtesë.

A. SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Klientët

SNRF 15 krijon një kuadër gjithëpërfshirës për të përcaktuar nëse, sa dhe kur do të njihen të ardhurat. Standardi i ri zëvendësoi SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 Kontratat e ndërtimit dhe interpretimet përkatëse. Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen kur një klient merr kontrollin e produkteve ose shërbimeve. Përcaktimi i kohës së transferimit të kontrollit - në një moment të caktuar kohor ose përgjatë periudhës- kërkon gjykim.

Shoqëria ka adoptuar SNRF 15 duke përdorur metodën e efektit kumulativ (pa lehtësi praktike). Efekti i zbatimit fillestar të këtij standardi është njohur në datën e zbatimit fillestar (d.m.th.1 janar 2018). Për këtë arsye, informacioni për 2017 nuk është riparaqitur por është prezantuar siç është raportuar më parë sipas SNK 18, SNK 11 dhe interpretimeve përkatëse. Gjithashtu, kërkesat e paraqitjes sipas SNRF 15 nuk janë zbatuar në përgjithësi për informacionin krahasues.

Të ardhurat operative nga shitja e produkteve: Sipas SNK 18, të ardhurat nga shitja e produkteve mateshin me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme në kohën kur produktet ishin dërguar te klientët, që ishte momenti në kohë kur klienti kishte pranuar produktet dhe rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të lidhura me pronësinë. Të ardhurat njiheshin nëse shuma e të ardhurave mund të matej në mënyrë të besueshme, kostot shoqëruese dhe kthimi i mundshëm i mallrave mund të vlerësoheshin në mënyrë të besueshme, arkëtimi i shumave ishte i mundshëm dhe nuk kishte përfshirje të vazhdueshme të drejtimit në lidhje me produktet.

Sipas SNRF 15, të ardhurat njihen në masën që ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ndodhë një kthim i rëndësishëm i shumës së të ardhurave të akumuluar të njohura. Për këtë arsye, për këto produkte nuk ka ndryshim në njohjen e të ardhurave sipas SNRF 15.

SNRF 15 nuk ka patur ndikim të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë në lidhje me burimet e tjera të të ardhurave (shih Shënimin 25).

Për informacion shtesë në lidhje me politikat kontabël të Shoqërisë lidhur me njohjen e të ardhurave, shih Shënimin 6 (i).

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

B. SNRF 9 Instrumentet Financiare

SNRF 9 parashtron kërkesa për njohjen dhe matjen e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe disa prej kontratave për blerjen apo shitjen e zërave jofinanciare. Ky standard zëvendëson SNK 39 Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja.

Si rezultat i adoptimit të SNRF 9, Shoqëria ka adoptuar ndryshime rrjedhimore të SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare, të cilat kërkojnë që zhvlerësimi i aktiveve financiare të paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e të fitimit ose humbjes dhe në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse. Më parë, qasja e Shoqërisë ishte të përfshinte zhvlerësimin e kërkesave për arkëtim nga klientët në shpenzime të tjera.

Për më tepër, Shoqëria ka adoptuar ndryshime rrjedhimore të SNRF 7 Instrumentet Financiare: shpjegimet që jepen në shënimet shpjeguese për 2018 por që përgjithësisht nuk janë zbatuar në informacionin krahasues.

i. Klasifikimi dhe matja e aktiveve financiare, detyrimeve financiare dhe instrumenteve të kapitalit

SNRF 9 përmban tre kategori kryesore për klasifikimin e aktiveve financiare: të matura me koston e amortizuar, me vlerën e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (“VDATGJ”) dhe vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (“VDPFH”). Klasifikimi i aktiveve financiare sipas SNRF 9 bazohet në modelin e biznesit sipas të cilit menaxhohet një aktiv financiar dhe karakteristikat e tij kontraktuale të rrjedhës së flukseve monetare. SNRF 9 eliminon kategoritë e mëparshme të SNK 39: të mbajtura deri në maturim, huatë dhe të arkëtueshme, të vlefshme për shitje. Sipas SNRF 9, instrumentet derivativë për të cilat aktivi bazë është një aktiv i përfshirë në objektin e standardit, nuk ndahen. Instrumenti financiar hibrid vlerësohet dhe klasifikohet si një i tërë.

SNRF 9 përgjithësisht ruan kërkesat ekzistuese të SNK 39 për klasifikimin dhe matjen e detyrimeve financiare. Adoptimi i SNRF 9 nuk ka patur efekt të rëndësishëm në politikat kontabël të Shoqërisë për detyrimet financiare.

Për më tepër shpjegime mbi mënyrën se si Shoqëria klasifikon dhe mat instrumentet financiare dhe llogaritë për fitimet dhe humbjet e lidhura me to sipas SNRF 9, shih Shënimin 6 (c).

Tabela e mëposhtme dhe shënimet shpjeguese përkatëse tregojnë kategoritë ekzistuese të matjes sipas SNK 39 dhe kategoritë e reja të matjes sipas SNRF 9 për çdo klasë të aktiveve dhe detyrimeve financiare më 1 janar 2018. Adoptimi i SNRF 9 nuk ka efekt në vlerën kontabël të aktiveve financiare në 1 janar 2018.

<i>Shumat në Lek</i>	Shënimi	Klasifikimi ekzistues sipas SNK 39	Klasifikimi i ri sipas SNRF 9	Vlera ekzistuese kontabël sipas SNK 39	Vlera e re kontabël sipas SNRF 9
<i>Aktivitet financiare</i>					
Kërkesa për arkëtim	12, 13	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e Amortizuar	109,405,744	109,405,744
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	16	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e Amortizuar	298,627,430	298,627,430
Depozita me afat	15	Hua dhe të arkëtueshme	Kosto e Amortizuar	557,800,000	557,800,000
Totali i aktiveve financiare				965,833,174	965,833,174
<i>Detyrimet financiare</i>					
Detyrime ndaj furnitorëve	20, 21	Detyrime të tjera financiare	Detyrime të tjera financiare	202,803,272	202,803,272
Totali i detyrimeve financiare				202,803,272	202,803,272
<i>Instrumentet e kapitalit</i>					
Investime	9	Të vlefshme për shitje	VDATGJ - instrumente të kapitalit	23,000,000	23,000,000
Totali i instrumenteve të kapitalit				23,000,000	23,000,000

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

5. Ndryshime në politikat e rëndësishme kontabël (vazhdim)

B. SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

ii. Zhvlerësimi i aktiveve financiare

SNRF 9 zëvendëson modelin e “humbjeve të pësuar” të SNK 39 me modelin e “humbjeve të pritshme të kredisë (HPK). Modeli i ri i zhvlerësimit aplikohet për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar, aktivet kontraktuale dhe investimet në titujt e borxhit me VDATGJ por jo për investimet në instrumente të kapitalit. Sipas SNRF 9, humbjet e kredisë njihen më shpejt në kohë krahasuar me SNK 39 - shih Shënimin 6 (d) (i). Për aktivet e përfshira në modelin e zhvlerësimit sipas SNRF 9, humbjet nga zhvlerësimi në përgjithësi priten të rriten dhe të bëhen më të ndryshueshme. Shoqëria ka vendosur që adoptimi i kërkesave të SNRF 9 në 1 janar 2018 nuk rezulton në shtesa në zhvlerësim.

iii. Tranzicioni në SNRF 9

Ndryshimet në politikat kontabël që rezultojnë nga adoptimi i SNRF 9 janë zbatuar retrospektivisht, përjashtuar rastet e paraqitura më poshtë.

- Shoqëria ka vendosur të mos rishikojë informacionin krahasues për periudhat e mëparshme lidhur me kërkesat për klasifikimin dhe matjen (përfshirë zhvlerësimin). Diferencat në vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare që rezultojnë nga adoptimi i SNRF 9 do të njihen në fitimet dhe rezervat e paspërndara në 1 janar 2018. Rrjedhimisht, informacioni i paraqitur për vitin 2017 nuk pasqyron kërkesat e SNRF 9 por ato të SNK 39.

- Përcaktimi i modelit të biznesit sipas të cilit është mbajtur një aktiv financiar është bazuar në faktet dhe rrethanat që kanë ekzistuar në datën e aplikimit fillestar.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhja e politikave kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të njëjtë në të gjithë periudhat të paraqitura në këto pasqyra financiare, përveçse nëse përmendet ndryshe (shih Shënimin 5).

(a) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike me përjashtim të instrumenteve të kapitalit me VDATGJ, të cilat maten me VDATGJ.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të matur me vlerën e drejtë përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur vlera e drejtë është përcaktuar. Zërat jo-monetarë në monedhë të huaj që maten me kosto historike janë konvertuar me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit përgjithësisht njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(c) Instrumentet financiare

i. Njohja dhe matjet fillestare

Shoqëria njihet për arkëtim fillimisht në datën kur ato krijohen. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën në të cilën Shoqëria bëhet pjesë e marrëveshjes kontraktuale të instrumentit.

Një aktiv financiar (përveç nëse është një kërkesë për arkëtim që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi) ose detyrim financiar, në njohjen fillestare do të matet me vlerën e drejtë të tij plus, në rastin e elementëve të përcaktuar jo me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, me koston e transaksionit që i ngarkohet drejtpërdrejt blerjes ose emetimit. Një kërkesë për arkëtim tregtare që nuk përmban një element të rëndësishëm financimi njihet fillimisht me koston e transaksionit.

ii. Klasifikimi dhe matjet e mëposhtme

Aktivet financiare - Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Në njohjen fillestare, aktivi financiar klasifikohet si i matur me: koston e amortizuar; VDATGJ- investimet kapitale; ose me VDPFH.

Aktivet financiare nuk riklasifikohen pas njohjes fillestare, përveç nëse Shoqëria ndryshon modelin e saj të biznesit për menaxhimin e aktiveve financiare, në këtë rast të gjitha aktivet financiare të ndikuara riklasifikohen në ditën e parë të periudhës së parë raportuese pas ndryshimit në modelin e biznesit.

Aktivi financiar matet me koston e amortizuar nëse plotëson të dyja kushtet e mëposhtme dhe nuk është i përcaktuar me VDPFH:

- është në një model biznesi, objektivi i të cilit është mbajtja e aktiveve për përfitim të flukseve monetare kontraktuale; dhe

- termat kontraktuale të aktivitetit përcaktojnë flukse të mjeteve monetare të cilat janë vetëm pagesa principali dhe interesit mbi shumën totale të pashlyer në data specifike.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentet financiare (vazhdim)

ii. Klasifikimi dhe matjet e mëpasshme (vazhdim)

Aktivet financiare - Vlerësimi i modelit të biznesit: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Shoqëria bën një vlerësim të objektivit të modelit të biznesit në të cilin një aktiv financiar mbahet në një nivel portofoli, sepse kjo mënyrë reflekton saktë drejtimin e biznesit dhe informacionin që i ofrohet Drejtimit. Informacioni përfshin:

- politikat dhe objektivat e deklaruara për portofolin dhe funksionimin e këtyre politikave në praktikë. Këto përfshijnë nëse strategjia e drejtimit fokusohet në fitimin e të ardhurave kontraktuale nga interesi, duke ruajtur një profit të caktuar të normës së interesit, duke përputhur kohëzgjatjen e aktiveve financiare me kohëzgjatjen e detyrimeve të lidhura me to ose daljen e flukseve monetare nëpërmjet shitjes së aktiveve;
- se si performanca e portofolit vlerësohet dhe raportohet tek drejtimi i Shoqërisë;
- rreziqet që ndikojnë në performancën e modelit të biznesit (dhe aktivet financiare të mbajtura brenda atij modeli të biznesit) dhe në veçanti, mënyra në të cilën këto rreziqe janë menaxhuar;
- si janë kompensuar drejtuesit e biznesit, nëse kompensimi është i bazuar në vlerën e drejtë të aktiveve të menaxhuara ose në bazë të flukseve monetare kontraktuale të mbledhura; dhe
- frekuenca, volumi dhe koha e shitjes së aktiveve financiare në periudha të mëparshme, arsyet e shitjeve dhe pritshmëritë për aktivitetin e ardhshëm të shitjes.

Transferimi i aktiveve financiare me palë të treta me anë të transaksioneve që nuk i plotësojnë kushtet për çregjistrim, nuk konsiderohen shitje për këtë qëllim, në përputhje me njohjen në vazhdimësi të aktiveve të Shoqërisë.

Aktivet financiare - Vlerësimi nëse flukset e mjeteve monetare kontraktuale janë vetëm pagesa e principalit dhe interesit: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018.

Për qëllim të këtij vlerësimi, 'principal' është vlera e drejtë e aktivitetit financiar në njohjen fillestare. 'Interesi' është shpërblimi për vlerën në kohë të parasë dhe për rrezikun e kredisë të lidhur me shumën e principalit të pashlyer gjatë një periudhe kohore të caktuar, për rreziqet dhe kostot e tjera bazë të kreditimit (p.sh. rreziku i likuiditetit dhe kostot administrative), duke përfshirë gjithashtu marzhin e fitimit.

Për të vlerësuar nëse flukset monetare kontraktuale janë pagesa vetëm të principalit dhe interesit, Shoqëria merr parasysh kushtet kontraktuale të instrumentit. Kjo përfshin vlerësimin nëse një aktiv financiar përmban një element kontraktual që mund të ndryshojë kohën ose shumën e flukseve monetare kontraktuale në mënyrë të tillë që nuk plotëson kushtin.

Gjatë vlerësimit, Shoqëria konsideron:

- ngjarje të kushtëzuara që mund të ndryshojnë kohën dhe shumën e flukseve monetare;
- kushte që mund të ndryshojnë normën kontraktuale të interesit, përfshirë normat e ndryshueshme;
- parapagimet dhe kushtet e shtyrjes; dhe
- kushtet që kufizojnë pretendimet e Shoqërisë për flukset monetare nga aktive të caktuara (tipare të pakthyeshme).

Një tipar parapagimi është në përputhje me kushtin e pagesës vetëm për principalin dhe interesin nëse shumat e parapaguar në thelb paraqet shumën e papaguar të principalit dhe të interesit mbi shumën e principalit të papaguar, të cilat mund të përfshijnë kompensim të arsyeshëm shtesë për ndërprerjen e hershme të kontratës. Gjithashtu, për një aktiv financiar të blerë me zbritje apo me prim mbi shumën kontraktuale, një tipar që lejon ose kërkon parapagim për një shumë që në thelb paraqet shumën kontraktuale plus interesa kontraktuale të përllogaritur (por të papaguar), interes kontraktual (që mund të përfshijë dhe shpërblim për përfundim të parakohshëm) trajtohet si të jetë në përputhje me këtë kriter nëse vlera e drejtë e tiparit të parapagimit është e parëndësishme në njohjen fillestare.

Aktivet financiare - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet: Politikë e zbatueshme nga 1 janar 2018

Aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar rrjedhimisht maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Kostoja e amortizuar reduktohet nga humbjet nga zhvlerësimi. Të ardhurat nga interesi, fitimi dhe humbja nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose humbje.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentet financiare (vazhdim)

ii. Klasifikimi dhe matja mëpasshme (vazhdim)

Instrumente të kapitalit me VDATGJ - Matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet: Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Shoqëria, në momentin fillestar të njohjes së një investimi në një instrument kapitali i cili nuk është i mbajtur për tregtim, mund të bëjë një zgjedhje të pakthyeshme për të paraqitur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse ndryshimet e mëpasshme në vlerën e drejtë të investimit. Kjo zgjedhje bëhet në bazë të secilit investim.

Fitimet ose humbjet nga instrumente të kapitalit nuk riklasifikohen asnjëherë në fitim ose humbje dhe asnjë zhvlerësim i tyre nuk njihet në fitim ose humbje. Dividendët nga investimi njihen në fitim ose humbje (shih Shënimin 6(1)). Fitimet dhe humbjet e akumuluar të njohura në të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse kalojnë në fitimet e pashpërndara në reduktim të investimit, dhe nuk riklasifikohen asnjëherë në fitim ose humbje.

Aktivet financiare - Politika e zbatueshme para 1 janar 2018

Shoqëria ka klasifikuar aktivet financiare në hua dhe llogari të arkëtueshme.

Aktivet financiare - Matjet e mëpasshme dhe fitimet e humbjet: Politika e zbatueshme para 1 janar 2018

Huatë dhe llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet financiare - Klasifikimi, matja e mëpasshme dhe fitimet e humbjet

Detyrimet financiare maten fillimisht me koston e amortizuar dhe pas njohjes fillestare ato maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Shpenzimet e interesit dhe fitimet dhe humbjet nga kursi i këmbimit dhe zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Çdo fitim ose humbje në momentin e çregjistrimit, njihet në fitim ose në humbje.

Instrumentet e kapitalit - Matja

Instrumentet financiare të vlefshme për shitje përfaqësojnë investime në kapital të matur me kosto për mungesë të të dhënave mbi vlerën e tyre të drejtë. Në vijim të njohjes fillestare, ato janë matur me kosto neto nga humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

iii. Çregjistrimi

Asetet financiare

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktivi financiar kanë skaduar, ose kur transferon të drejtat për të marrë flukse kontraktuale në një transaksion me anë të së cilit të gjithë rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar, ose me anë të së cilit Shoqëria nuk transferon as mbart të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe ajo nuk mban kontrollin e aktivit financiar.

Shoqëria bëhet pjesë e transaksioneve me anë të të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar por ruan pjesën më të madhe ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktiveve të transferuara. Në të tilla raste, aktivet e transferuara nuk çregjistrohen.

Detyrimet financiare

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet e saj kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Shoqëria gjithashtu çregjistron një detyrim financiar kur kushtet e tij kontraktuale ndryshojnë dhe flukset e mjeteve monetare të detyrimit të modifikuar ndryshojnë thelbësisht. Në këtë rast njihet, një detyrim i ri financiar i bazuar në kushtet e modifikuara, njihet me vlerën e drejtë.

Në çregjistrimin e një detyrimi financiar, diferenca midis vlerës kontabël neto dhe shumës së paguar (duke përfshirë çdo aktiv financiar të transferuar apo detyrime të marra) njihet në fitim ose humbje.

iv. Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Shoqëria ka një të drejtë ligjore për të shlyer shumat dhe ka për qëllim ti shlyejë ato në baza neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Zhvlerësimi

(i) Aktivet financiare jo-derivative

Politika e zbatueshme nga 1 janar 2018

Instrumentet financiare

Shoqëria njihet një zbritje për HPK për aktivet financiare të njohura me koston e amortizuar dhe e mat zbritjen në një shumë të barabartë me totalin e HPK përgjatë jetës së aktivit. Shoqëria e konsideron një aktiv financiar në rrezik mosshlyerje kur:

- kundërpartia ka pak gjasa të paguajë detyrimet e plota ndaj Shoqërisë pa masa shtrënguese nga ana e Shoqërisë siç është realizimi i garancisë (nëse ka një të tillë) ose;
- pagesat për aktivin financiar janë vonuar më tepër se 90 ditë.

HPK përgjatë gjithë jetës së aktivit janë HPK që rezultojnë nga ngjarjet që mund të ndodhin gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. Periudha maksimale e konsideruar gjatë vlerësimit të HPK është periudha maksimale kontraktuale gjatë së cilës Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë.

Matja e HPK

HPK maten si mesatare e ponderuar sipas probabilitetit të ndodhjes së humbjeve të kredisë. Humbjet kreditore janë vlera aktuale e diferencave në flukset monetare (diferenca mes flukseve të mjeteve monetare që duhet t'i paguhen Shoqërisë në përputhje me kontratën dhe flukseve të mjeteve monetare që Shoqëria pret të marrë).

Aktivitetet financiare të zhvlerësuar

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar janë zhvlerësuar. Një aktiv financiar është zhvlerësuar nëse ka ndodhur një ose më tepër ngjarje që kanë ndikim të ndjeshëm në flukset monetare të ardhshme. Të dhënat e verifikueshme që tregojnë se një aktiv financiar është i zhvlerësuar janë:

- vështirësi të mëdha financiare të debitorit;
- shkelje e kontratës ose debitori është më tepër se 90 ditë me vonesë në kryerjen e pagesës;
- është e mundur që debitori do të falimentojë ose do të riorganizohet financiarisht.

Paraqitja e zbritjes për HPK në pasqyrën e pozicionit financiar.

Humbjet për aktivet financiare të matura me koston e amortizuar zbriten nga vlera kontabël bruto e aktiveve.

Fshirja

Vlera kontabël bruto e një aktivi financiar fshihet kur Shoqëria nuk ka pritshmëri për rikuperimin e plotë ose të pjesshëm të aktivitetit financiar. Shoqëria bën një vlerësim individual në lidhje me kohën dhe shumën e fshirjes duke patur parasysh mundësinë e arsyeshme të rikuperimit. Shoqëria nuk pret rimarrje të konsiderueshme nga shuma e fshirë. Megjithatë, aktivet financiare që janë fshirë mund të jenë ende subjekt i masave shtrënguese në përputhje me procedurat e Shoqërisë për rikuperimin e shumave të pashlyera.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhja e politikave kontabël (vazhdim)

(d) Zhvlerësimi (vazhdim)

(i) Aktivet financiare jo-derivative (vazhdim)

Politika e zbatueshme para 1 janari 2018

Aktivitetet financiare vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidencë objektive të mjaftueshme për zhvlerësim. Evidencat objektive përfshijn: mospagim ose pa-aftësi paguese nga një debitor, tregues që një debitor falimenton, ndryshime jo të favorshme në statusin e pagesave të një debitori dhe të dhëna të verifikueshme që tregonin për një ulje të matshme në flukset e ardhshme monetare nga aktivitetet financiare.

Shoqëria konsideronte evidencën për zhvlerësim të këtyre aktiveve në nivel individual dhe kolektiv. Aktivitetet financiare individualisht të rëndësishme testoheshin për zhvlerësim mbi baza individuale. Ato të cilat nuk janë zhvlerësuar rishikoheshin së bashku për ndonjë zhvlerësim që mund të ketë por i paidentifikuar në mënyrë individuale. Aktivitetet të cilat nuk ishin individualisht të rëndësishme vlerësoheshin për zhvlerësim mbi baza kolektive. Zhvlerësimi kolektiv realizohej duke grupuar aktivitetet me karakteristika të përbashkëta rreziku.

Në vlerësimin e zhvlerësimit kolektiv, Shoqëria përdorte informacion historik mbi kohën e rimarrjes dhe vlerën e humbjes së ndodhur, dhe bënte një rregullim në rast se kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditimit ishin të tilla që humbjet faktike kishin mundësi të ishin më të mëdha ose më të vogla se trendet historike.

Humbja nga zhvlerësimi llogaritej si diferenca midis vlerës së mbetur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me normën efektive fillestare të interesit të aktivitetit. Humbjet njiheshin në fitim ose humbje dhe paraqiteshin në një llogari zbritjeje. Kur Shoqëria konsideronte se nuk ekzistonin perspektiva realiste mbi rikuperimin e aktivitetit, shumatat respektive fshiheshin nga kontabiliteti. Në qoftë se shumata e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohej më pas, dhe zbritja lidhej objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, atëherë shumata e mëparshme e humbjes zhvlerësimi rimerrej në pasqyrën e fitimit ose humbjes.

(ii) Asetet jofinanciare

Në çdo datë raportimi, Shoqëria rishikon vlerat kontabël të aktiveve të saj jo-financiare (të ndryshme nga inventarët) për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues për zhvlerësim. Nëse tregues të tillë ekzistojnë, atëherë bëhet vlerësimi i vlerës së rikuperueshme të aktivitetit.

Për testimin e zhvlerësimit, aktivitetet grumbullohen së bashku në grupin më të vogël gjenerues të përfitimeve nga përdorimi i vazhdueshëm (NjGjP). Shumata e rikuperueshme e një aktiviteti ose (NjGjP) është vlera më e madhe midis vlerës së përdorimit dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Vlera e përdorimit bazohet në flukset e pritura të vlerësuar, të aktualizuara me një normë para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike ndaj aktivitetit ose NjGjP.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e aktivitetit ose NjGjP tejkalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje. Ato u shpërndahen në bazë proporcionale aktiveve të NjGjP për të zvogëluar vlerat e tyre të mbetura.

Një humbje nga zhvlerësimi anulohet vetëm në masën që vlera e mbetur e aktivitetit nuk tejkalon vlerën e mbetur që do të përcaktohej, neto prej amortizimit dhe zhvlerësimit, nëse humbja prej zhvlerësimit nuk do të njihet.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(e) Aktivet afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matjet

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto ose kosto të supozuar të pakësuar për amortizimin e akumuluar (shih më poshtë) dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësinë e dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elemente të veçanta (komponentë kryesorë) të aktiveve afatgjata materiale.

Humbja ose fitimi nga shitja e një aktivi afatgjatë material njihet në fitim ose humbje.

(ii) Kostot vijuese

Kostot vijuese kapitalizohen vetëm nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të përfitohen nga Shoqëria.

(iii) Amortizimi

Amortizimi llogaritet për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale pakësuar me vlerën e përlllogaritur të mbetur duke përdorur metodën e amortizimit mbi vlerën kontabël neto përgjatë jetës së tyre të dobishme, dhe përgjithësisht njihet në fitim ose humbje. Toka, aktive të tjera dhe punimet në proces nuk amortizohen.

Normat respektive të amortizimit për periudhën raportuese dhe krahasuese janë si më poshtë:

E drejta e përdorimit të tokës	1.01%
Ndërtesa dhe instalime	2.5%
Makineri dhe pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Ambalazh i rikthyeshëm dhe pajisje ftohëse	20%
Pajisje zyrash, mobilje dhe orendi	20-25%

Metodat e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlerat e mbetura të aktiveve materiale afatgjatë rishikohen dhe nëse është e nevojshme, rregullohen në çdo datë raportimi.

(f) Inventarët

Inventarët vlerësohen me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kosto e inventarit përlllogaritet bazuar në metodën “hyrje e parë, dalje e parë”. Në rastin e inventarit të prodhuar dhe punës në proces, kosto përfshin një pjesë të kostove të prodhimit bazuar në kapacitetin normal të shfrytëzimit.

(g) Përfitimet e punonjësve

Përfitimet afatshkurtra

Detyrimet për përfitimet afatshkurtra të punonjësve njihen si shpenzim kur shërbimi përkatës kryhet. Një detyrim njihet për shumën që pritet të paguhet nëse Shoqëria ka një detyrim ligjor apo strukturor për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara, të kryera nga punonjësi dhe detyrimi mund të vlerësohet me besueshmëri.

Pensioni i detyrueshëm

Shoqëria, në rrjedhën normale të biznesit të saj, kryen pagesa për llogari të saj dhe për llogari të punonjësve të saj për të kontribuar për pensionet në përputhje me legjislacionin vendas. Kontributet e Shoqërisë ndaj planit të pensioneve ngarkohen në fitim ose humbje kur ato ndodhin.

(h) Provizionet

Provizionet njihen kur Shoqëria ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara, që mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të kërkohej një fluks dalës të mirash ekonomike për të shlyer detyrimin. Provizionet llogariten duke skontuar flukset e ardhshme monetare më një normë përpara tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike të detyrimit. Amortizimi kohor i skontimit njihet si kosto financiare. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe në rast se nuk është më e mundur që të shoqërohet me dalje të flukseve monetare, provizionet anulohen. Provizionet përdoren vetëm për qëllimin për të cilin njihen në fillim. Provizionet nuk njihen për humbje të ardhshme operative.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(i) Njohja e të ardhurave

Efekti i zbatimit fillestar të SNRF 15 mbi të ardhurat e Shoqërisë nga kontratat me klientët paraqitet në Shënimin 5 A. Për shkak të metodës së tranzicionit të zgjedhur për zbatimin e SNRF 15, informacioni krahasues në këto pasqyra financiare nuk është riparaqitur për të pasqyruar kërkesat e standardeve të reja.

Nëse është e mundur që Shoqëria të ketë përfitime ekonomike të ardhshme dhe nëse të ardhurat dhe kostot mund të maten në mënyrë të besueshme, të ardhurat njihen në pasqyrën e fitim ose humbjes si në vijim:

Shitja e produkteve

Të ardhurat maten duke u bazuar në kushtet e specifikuara në kontratën e lidhur me klientin. Shoqëria njeh një të ardhur kur transferon kontrollin e një malli apo shërbimi tek klienti.

Natyra dhe koha e përmbushjes së detyrimeve të performancës, përfshirë kushtet e konsiderueshme të pagesave
Klientët marrin kontrollin e produkteve kur produktet dërgohen dhe pranohen nga ata. Faturat gjenerohen në atë moment në kohë. Klientëve u ofrohen zbritje në bazë të volumit të blerjeve gjatë vitit.

Njohja e të ardhurave sipas SNRF 15 (e zbatueshme nga 1 janar 2018)

Të ardhurat njihen kur produktet janë dërguar dhe janë pranuar nga klientet. Zbritjet tregtare trajtohen si shumë e ndryshueshme. Shumat e ndryshueshme do përfshihen në të ardhura kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ketë ndryshim të konsiderueshëm të shumës së akumuluar të të ardhurave kur pasiguritë e çmimit të qartësohen.

Për kontratat që i lejojnë klientit kthimin e artikujve, të ardhurat do të njihen kur ekziston probabilitet i lartë që nuk do të ndodhë kthim i konsiderueshëm në të ardhurat e akumuluar të njohura. Rrjedhimisht, të ardhurat e njohura do të rregullohen për kthimet e pritura, të cilat vlerësohen duke u bazuar në të dhëna historike. Në këto rrethana, njihet një detyrim për rimbursim dhe një e drejtë për të rimarrë produktin e kthyer. E drejta për të rimarrë produktet e kthyer njihet me vlerën e mëparshme kontabël të inventarit minus kostot e pritura për të rimarrë produktet. Çdo detyrim për rimbursim përfshihet në llogaritë e pagueshme dhe e drejta për të rimarrë produktet e kthyer përfshihet në inventar. Shoqëria rishikon vlerësimet për kthimet e pritura në çdo datë raportimi dhe përditëson shumat e aktiveve dhe detyrimeve bazuar në vlerësimin e ri.

Njohja e të ardhurave sipas SNK 18 (e zbatueshme para 1 janar 2018)

(i) Mallrat dhe te tregtueshmet

Të ardhurat njiheshin kur rreziqet dhe përfitimet e rëndësishme të pronësisë ishin transferuar tek klienti, ishte e mundur marrja e shumës, kostot shoqëruese dhe kthimet e mundshme të të mirave dhe shërbimeve mund të vlerësoheshin në mënyrë të besueshme, nuk ka kishte përfshirje të vazhdueshme të drejtimit me mallrat dhe shuma e të ardhurave mund të matej në mënyrë të besueshme. Të ardhurat mateshin neto nga kthimet, skontot tregtare apo uljet në bazë të vëllimit. Koha e transferimit të rreziqeve dhe përfitimeve ishte në varësi të termave të kontratës së shitjes.

Për shitjet e produkteve industriale dhe tregtare, transferimi ndodhte kur produktet ishin ngarkuar në mjetin përkatës të transportit, vetëm nëse marrëveshja e shkruar shprehet ndryshe.

(ii) Services

Të ardhurat nga shërbimet e kryera njiheshin në fitim ose humbje në përputhje me fazën e përfundimit të transaksionit në datën e raportimit. Faza e përfundimit vlerësohej duke iu referuar vëzhgimeve të punës së kryer.

(j) Rimbursimet e kostos së programeve të marketingut

Rimbursimet për programet e marketingut për të promovuar shitjen e produkteve të liçensuara janë të njohura si të ardhura të vitit në të cilin kanë ndodhur edhe shpenzimet përkatëse. Rimbursimi i kostove të shitjes është njohur si e ardhur në të njëjtën kohë me shitjet e produkteve të cilave i referohet.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

6. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

(k) Qiratë

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në fitim ose humbje në mënyrë lineare gjatë periudhës së qirasë. Stimujt e qirasë së marrë njihen si një pjesë integrale e shpenzimeve totale të qirasë, gjatë periudhës së qirasë. Aktivitetet e mbajtura me qira operative klasifikohen si të tilla dhe nuk njihen në pasqyrën e pozicionit financiar të Shoqërisë.

(l) Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi njihen duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendi njihen në fitim ose humbje në datën në të cilën vendoset e drejta e Shoqërisë për të marrë pagesën. Fitimet dhe humbjet nga këmbimi në monedha të huaja paraqiten për shumën neto si e ardhur ose shpenzim financiar në varësi nëse lëvizjet e monedhave të huaja janë në fitim ose humbje neto.

(m) Shpenzimi për tatim fitimin

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet nga tatimi aktual dhe tatimi i shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital ose në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse. Interesat dhe gjobat që lidhen me tatim fitimin, përfshirë trajtimet e paqarta fiskale kontabilizohen sipas *SNK 37 Provizione, Detyrimet e Kushtëzuara dhe Aktivitetet e Kushtëzuara*.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi fitimin ose humbjen e vitit, dhe çdo sistemim i tatimit të pagueshëm ose të arkëtueshëm për vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshëm është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit të pritshëm për tu paguar ose arkëtuar që reflekton pasigurinë që lidhen me tatim fitimin. Ky tatim llogaritet duke përdorur normat e tatimit në fuqi ose të cilat kanë hyrë në fuqi thelbësisht në datën e raportimit.

Aktivitetet aktuale tatimore dhe detyrimet mund të kompensohen vetëm nëse kritere të caktuara përmbushen.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet në përputhje me diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimore.

Tatimi i shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore dhe diferencat e përkohshme të zbritshme për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoren. Fitimet e ardhshme të tatueshme përcaktohen bazuar në anulimin e diferencave përkatëse të përkohshme të tatimit. Nëse shuma e diferencave të përkohshme është e pamjaftueshme për të njohur një aktiv tatim të shtyrë të plotë, atëherë fitime të ardhshme të tatueshme, të rregulluar me anulimet e diferencave ekzistuese të përkohshme, konsiderohen, bazuar në planin e biznesit. Aktivitetet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi tatimor i lidhur me to të realizohet; të tilla reduktime anulohen kur probabiliteti i fitimeve të ardhshme të tatueshme përmirësohet.

Aktivitetet tatimore të shtyra të panjohura rishikohen në çdo datë raportimi dhe njihen në masën që është e mundur që fitime të ardhshme të tatueshme mund të ekzistojnë ndaj të cilave mund të përdoret.

Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore të cilat pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato anulohen, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të hyrë në fuqi në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të rezultojnë nga mënyra që Shoqëria pret, në datën e raportimit, të rikuperojë ose shlyejë vlerën e mbetur të aktiveve dhe detyrimeve. Për këtë qëllim, vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale të investuara e matur me vlerë të drejtë supozohet të rikuperohet përmes shitjes dhe Shoqëria nuk e ka hedhur poshtë këtë supozim.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen vetëm në rast se kritere të caktuara përmbushen.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Standardet dhe interpretimet e reja ende të pa adoptuara

Disa standarde të reja dhe ndryshime në standardet e interpretimet ekzistuese që janë efektive për periudhat që fillojnë pas datës 1 janar 2018 dhe zbatimi i hershëm është i lejuar, nuk janë adoptuar në mënyrë të hershme nga Shoqëria në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare. Nga standardet që nuk janë ende efektive, SNRF 16 pritet të ketë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë në periudhën e aplikimit fillestar.

SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 zëvendëson SNK 17 *Qiratë* dhe interpretimet e lidhura. Standardi eliminon modelin aktual të kontabilitetit me dy modele për qiramarrësit dhe në vend të saj kërkon që shoqëritë të pasqyrojnë qiratë në bilanc sipas një modeli të vetëm, duke eliminuar dallimin midis qirasë operative dhe qirasë financiare.

Sipas SNRF 16, kontrata është ose përmban një qira, nëse kontrata jep të drejtën e kontrollit mbi përdorimin e një aktivi të identifikueshëm për një periudhë kohe në këmbim të një shume. Për kontrata të tilla, modeli i ri kërkon që qiramarrësi të njohë një aktiv për të drejtën e përdorimit si dhe një detyrim qiraje. Aktivi amortizohet dhe mbi detyrimin llogaritet interes. Kjo do të rezultojë në një model ku shpenzimet janë më të larta në periudhën fillestare dhe më pas vijjnë duke u reduktuar për shumicën e qirave, edhe nëse qiramarrësi paguan këste fikse vjetore.

Një qiramarrës mund të zgjedhë të mos zbatojë kërkesat e standardit për:

- qiratë me një afat 12 muaj ose më pak dhe që nuk përmbajnë opsion blerje; dhe
- qiratë për të cilin aktivi bazë është me vlerë të ulët.

Shoqëria do fillojë aplikimin e SNRF 16 më 1 janar 2019 duke zbatuar modelin e qasjes retrospektive të modifikuar. Efekti kumulativ i zbatimit të SNRF 16 do të njihet si rregullim i balancës hapëse të fitimit të mbartur më 1 janar 2019, pa riparaqitje të informacionit krahasues.

Shoqëria planifikon të zbatojë lehtësinë praktike për trashëguar përkufizimin e qirasë në tranzicion. Pra, do të aplikojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e lidhura para 1 janar 2019 dhe të identifikua si qira në përputhje me SNK 17 dhe IFRIC 4.

Pritet që standardi i ri, në zbatimin fillestar të ketë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare, pasi do Shoqëria duhet të njohë në pasqyrën e pozicionit financiar aktivet dhe detyrimet e lidhura me qiratë operative për të cilat Shoqëria është qiramarrës.

Shoqëria do të njohë aktive dhe detyrime të reja për qiratë operative të automjeteve, magazinës, burimit të ujit dhe apartamentit. Shpenzimet e qirasë dhe natyra e tyre do të ndryshojë pasi Shoqëria do të amortizojë të drejtën e përdorimit të aktivitetit dhe do të njohë shpenzim interesi mbi detyrimin për qiranë.

Më parë, Shoqëria ka njohur shpenzimet e qirasë operative në baza lineare gjatë kohëzgjatjes së qirasë dhe ka njohur aktiv dhe detyrim vetëm kur ka patur diferencë kohore midis pagesave të qirasë dhe shpenzimeve të njohura.

Shoqëria ende nuk ka përfunduar një analizë të ndikimit sasior të pritur të standardit të ri. Ndikimi faktik i adoptimit të standardit të ri më 1 janar 2019 mund të ndryshojë pasi politikat e reja kontabël janë subjekt ndryshimi deri sa Shoqëria të paraqesë pasqyrat e para financiare që përfshijnë datën e zbatimit fillestar.

Më 31 dhjetor 2018, pagesat e ardhshme të paskontuara të kontratave të qirasë sipas kushteve kontraktuale janë 113 milionë Lek.

Për pagesat e ardhshme minimale, të paskontuara të qirasë operative të paanulueshme në datën 31 dhjetor 2018, shih shënimin 31.

Kontabiliteti për qiradhënësin do të mbetet kryesisht i pandryshuar dhe do të ruhet dallimi ndërmjet qirasë operative dhe financiare.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

7. Standarde dhe interpretime të reja ende jo në fuqi (vazhdim)

Standarde dhe interpretime të tjera

Ndryshimet e mëposhtme në standarde dhe interpretime nuk pritet të kenë ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare të Shoqërisë:

- *KIRFN 23 Pasiguritë mbi Trajtimet e Tatimit mbi Fitimin;*
- *Veçoritë e Parapagimit me Kompensim Negativ (Ndryshimet në SNRF 9);*
- *Ndryshimet, Shkurtime ose Shlyerjet e Planit të Pensioneve (Ndryshimet në SNK 19);*
- *Përmirësimet vjetore të SNRF: Periudha 2015-2017 – disa standarde;*
- *Ndryshimet në referencat e Kornizës Konceptuale të Standarteve SNRF*
- *Përkufizimi i materiaitetit – (Ndryshime në SNRF 1 dhe SNK 28);*

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale

Aktivët afatgjata materiale më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 paraqiten si më poshtë:

	Tokë	E drejta e përdorimit të tokës	Ndërtesa dhe instalime	Makineri dhe Pajisje	Mjete transporti	Ambalazh i rikthyeshëm dhe pajisje ftohëse	Mobilje dhe Pajisje zyre	Të Tjera	Punime në proces	Totali
Kosto										
Më 1 janar 2017	16,795,602	62,700,000	817,607,249	1,424,465,559	64,071,381	423,356,222	149,242,471	5,002,303	10,701,103	2,973,941,890
Shtesa	660,000	-	9,744,718	110,143,013	233,361	78,382,624	5,618,867	337,673	1,982,197	207,102,453
Transferime	-	-	-	8,286,496	-	-	635,799	-	(8,922,295)	-
Pakësime	-	-	-	(112,348,437)	-	(8,655,997)	-	-	-	(121,004,434)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(40,322,402)	(11,328,740)	(46,357,875)	(8,946,733)	(250,586)	-	(107,206,336)
Më 31 dhjetor 2017	17,455,602	62,700,000	827,351,967	1,390,224,229	52,976,002	446,724,974	146,550,404	5,089,390	3,761,005	2,952,833,573
Shtesa	168,000	-	50,463,575	72,479,627	-	104,693,860	6,975,727	842,048	13,677	235,636,514
Transferime	-	-	1,982,197	-	-	-	-	-	(1,982,197)	-
Pakësime	-	-	-	(2,693,714)	(1,584,042)	(757,095)	-	-	-	(5,034,851)
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	(25,898,610)	(404,896)	(22,769,188)	(10,936,587)	(165,431)	-	(60,174,712)
Më 31 dhjetor 2018	17,623,602	62,700,000	879,797,739	1,434,111,532	50,987,064	527,892,551	142,589,544	5,766,007	1,792,485	3,123,260,524
Amortizimi i akumuluar										
Më 1 janar 2017	-	(14,565,210)	(277,179,975)	(1,223,190,998)	(49,957,464)	(219,553,944)	(103,522,731)	(153,464)	-	(1,888,123,786)
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(13,520,769)	(53,400,933)	(2,822,785)	(49,821,463)	(11,466,275)	-	-	(131,665,495)
Pakësime	-	-	-	109,868,063	-	5,160,729	-	-	-	115,028,792
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	36,283,970	10,397,925	37,423,491	7,185,465	16,410	-	91,307,261
Më 31 dhjetor 2017	-	(15,198,480)	(290,700,744)	(1,130,439,898)	(42,382,324)	(226,791,187)	(107,803,541)	(137,054)	-	(1,813,453,228)
Amortizimi i vitit	-	(633,270)	(13,714,673)	(57,710,983)	(2,023,024)	(58,770,451)	(10,091,533)	-	-	(142,943,934)
Pakësime	-	-	-	2,162,387	956,441	360,874	-	-	-	3,479,702
Nxjerrje nga përdorimi	-	-	-	24,312,389	237,035	15,213,411	8,732,618	14,354	-	48,509,807
Më 31 dhjetor 2018	-	(15,831,750)	(304,415,417)	(1,161,676,105)	(43,211,872)	(269,987,353)	(109,162,456)	(122,700)	-	(1,904,407,653)
Vlera kontabël										
Më 1 janar 2017	16,795,602	48,134,790	540,427,274	201,274,561	14,113,917	203,802,278	45,719,740	4,848,839	10,701,103	1,085,818,104
Më 31 dhjetor 2017	17,455,602	47,501,520	536,651,223	259,784,331	10,593,678	219,933,787	38,746,863	4,952,336	3,761,005	1,139,380,345
Më 31 dhjetor 2018	17,623,602	46,868,250	575,382,322	272,435,427	7,775,192	257,905,198	33,427,088	5,643,307	1,792,485	1,218,852,871

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

8. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

Toka në përdorim është një e drejtë përdorimi mbi tokën që përfaqëson kontributin në natyrë nga aksionari, Invest P.F në kapitalin e nënshkruar. E drejta e përdorimit të tokës në të cilën ndodhet ndërtesa e Shoqërisë është e vlefshme për nëntëdhjetë e nëntë (99) vite që nga fillimi i aktivitetit të Shoqërisë. Të drejtës së përdorimit i mbaron afati në vitin 2092 dhe ka një amortizim vjetor 633,270 Lek.

Sigurimi

Nuk ka ndonjë aktiv afatgjatë material të lënë si kolateral për ndonjë kredi deri më 31 dhjetor 2018 dhe 2017.

Amortizimi

Amortizimi ndahet midis kostos së shitjes për vlerën 72,058,926 Lek (2017: 67,554,972 Lek) dhe shpenzimeve të amortizimit për vlerën 70,885,008 Lek (2017: 64,110,523 Lek).

9. Investime

Investimi prej 27,000,000 Lek përfaqëson 2.16% (2017: 2.16%) investim të Shoqërisë në kapitalin e nënshkruar të Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk, një shoqëri e ambalazhimit të ujit në Shqipëri, shoqëria mëmë përfundimtare e së cilës është ACIES.

Më 1 janar 2018, Shoqëria njih investimin në instrumente kapitali me VDATGJ, meqenëse investimi pritet të mbahet për një periudhë afatgjatë për qëllime strategjike. Në 2017, investimi ishte konsideruar i vlefshëm për shitje dhe i mbajtur me kosto (shih Shënimin 5). Vlera e mbartur më 1 janar 2018 përfaqëson Vlerën e Drejtë në datën e raportimit (shih Shënimin 5).

	Vlera e drejtë më 31 dhjetor 2018	Të ardhura nga Dividendët gjatë 2018
Investimi neto të Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk	23,000,000	885,600

10. Huadhënie

Huadhënia e Shoqërisë është e përbërë si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Afatgjatë		
Hua	185,130,000	-
	185,130,000	-
Afatshkurtër		
Pjesa afatshkurtër e huasë (Shënimi 14)	2,838,043	-
	2,838,043	-

Gjatë vitit 2018, Shoqëria ka lidhur një marrëveshje huaje me ACIES me afat maturimi në datë 31 dhjetor 2024 dhe ka një interes vjetor me një normë të luhateshme Euribor 1Y + 3.5% por jo më pak se 3.5% dhe jo më të lartë se 6%. Huadhënia do të disbursohet sipas planit në vijim:

- EUR 1,500,000 deri më 31 dhjetor 2018;
- EUR 1,000,000 deri më 31 dhjetor 2019;
- EUR 1,000,000 deri më 31 dhjetor 2020;
- EUR 1,000,000 deri më 31 dhjetor 2020;
- EUR 500,000 deri më 31 dhjetor 2022;

Në vitin 2018, Shoqëria ka disbursuar shumën prej 1,500,000 Euro, ekuivalente me 185,130,000 Lekë në datën e raportimit.

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

11. Inventarë

Inventarët më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 mund të përmbliidhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Materiale	112,973,566	152,085,004
Produkte të gatshme	92,749,475	57,694,404
Karburante	2,330,058	1,355,358
	208,053,099	211,134,766

Vlera e produkteve të gatshme më 31 dhjetor 2018 është rritur për shkak të prodhimit gjatë muajit dhjetor për të mbuluar shitjet e janarit, kryesisht për promocionin “Affordability” të planifikuar për në janar 2019. Rritja e produktit të gatshëm është shoqëruar me ulje të lëndëve të para për balancën e 31 dhjetor 2018

Vlera kontabël e inventarëve në fund të vitit paraqitet me vlerën neto të realizueshme. Vlerat e inventareve jashtë përdorimit, janë përfshirë në kostot e shitjes (shih Shënimin 24).

12. Kërkesa për arkëtim nga klientët

Kërkesa për arkëtim më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përfaqësojnë të arkëtueshmet nga shitja e produkteve dhe mallrave. Në fund të vitit nuk është njohur ndonjë zhvlerësim për kërkesat e arkëtueshme nga klientët.

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Klientë direkt	15,453,988	12,401,025
Distributorë	4,179,405	10,413,377
Të tjerë	4,774,057	891,672
	24,407,450	23,706,074

Në 2018, Shoqëria ka fshirë kërkesa për arkëtim nga klientët në shumën 4.4 milion lekë.

13. Kërkesa për arkëtim nga palët e lidhura

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
SIBEG Srl	14,456,431	21,183,721
Uji i Ftohtë Tepelenë Shpk	10,175,838	13,147,791
S.A. Coca-Cola Services	32,349,369	51,324,150
Crilu Shpk	22,500	44,008
	57,004,138	85,699,670

Shoqëria merr pjesë në programe të ndryshme marketingu të mbështetura nga S.A. Coca-Cola Services (CCS). Sipas këtyre programeve, një pjesë e shpenzimeve të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 rimbursohen nga CCS (shih shënimin 25 dhe 32).

14. Aktive të tjera afatshkurtra

Aktive të tjera afatshkurtra më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 mund të përmbliidhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Shpenzimet e parapaguara	15,886,299	7,405,467
Parapagime ndaj furnitorëve	39,277,348	14,270,412
Interesa të maturuara	2,838,043	1,163,897
Të tjera	243,952	45,782
	58,245,642	22,885,558

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

15. Depozita me afat

Depozitat me afat më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Depozita me afat	458,216,840	557,800,000
	458,216,840	557,800,000

Më 31 dhjetor 2018, depozitat me afat në lekë përbëhen nga 26 milionë lekë (2017: 26 milionë lekë), që kanë një normë vjetore interesi prej 0.8 për qind me Procredit Bank Albania.

Depozita me afat në shumën 1 milionë EUR (2017: EUR 1 milion, ekuivalentë në Lek 133 milionë) që kanë një normë vjetore interesi prej 0.05% dhe 2.5 milionë EUR ekuivalente në Lek 305 milionë (2017: EUR 3 milion, ekuivalente në Lek 399 milionë) që kanë një normë vjetore interesi prej 0.01%. dhe janë vendosur si garanci bankare nga Shoqëria në emër të ACIES (shoqëria mëmë perfundimtare) në Intesa Sanpaolo Bank Albania. (ju lutem referojuni Shënimit 32).

16. Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentët me to më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2018	31 dhjetor 2017
Vlera në banka rezidente	173,322,968	295,880,611
Vlera në arkë	1,140,297	1,046,819
Depozita me afat maturimi më pak se 3 muaj	1,700,000	1,700,000
Totali	176,163,265	298,627,430

17. Kapitali i paguar

Kapitali i paguar i Shoqërisë më 31 dhjetor 2018 është 1,493,040,000 mijë Lek (2017: 1,493,040,000 Lek). Struktura e kapitalit të nënshkruar të paguar përbëhet nga 1 kuotë prej 1,115,151,756 Lek, 1 kuotë prej 338,173,560 Lek dhe 1 kuotë prej 39,714,864 Lek. Në përputhje me legjislacionin Shqiptar, interesat e pjesëmarrjes në Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar përfaqësohen nga ortakët, të cilët mbajnë vetëm një kuotë. Kuota përfaqëson pjesëmarrjen e ortakëve në kapitalin e shoqërisë dhe çdo kuotë mbart të drejtën e votës në përpjesëtim me pjesën e kapitalit të përfaqësuar nga kuota.

Më poshtë jepet përmbledhja e strukturës së kapitalit të Shoqërisë:

	31 dhjetor 2018			31 dhjetor 2017		
	Numri i kuotave	Pjesmarrja në %	Lek	Numri i kuotave	Pjesmarrja në %	Lek
SIBEG	1.00	74.69	1,115,151,576	1.00	74.69	1,115,151,576
TCCEC	1.00	22.65	338,173,560	1.00	22.65	338,173,560
Invest P.F.	1.00	2.66	39,714,864	1.00	2.66	39,714,864
	3.00	100	1,493,040,000	3.00	100	1,493,040,000

Dividendët

Ortakët zotërojnë të drejtën e përfitimit të dividendit të deklaruar dhe të drejtën e votës në mbledhjet e përgjithshme të Shoqërisë, në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota. Të gjitha të drejtat e votimit në përpjesëtim me pjesën e kapitalit përfaqësuar nga kuota renditen në mënyrë të barabartë lidhur me aktivet e mbetura të Shoqërisë.

Më 17 prill 2018 mbledhja e Këshillit Administrativ aprovoi shpërndarjen e dividendit për vitin fiskal 2017.

Fitimi neto për vitin 2017	390,834,196
Fitimi i mbartur nga viti 2008	16,877,292
Dividendë të shpërndarë dhe paguar në 2018	(407,711,488)

Coca-Cola Bottling Shqipëria Shpk

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare

(Shumat në Lek, përveçse kur shprehet ndryshe)

18. Rezerva ligjore

Sipas ligjit të mëparshëm shqiptar të shoqërive tregtare, shoqërive tregtare u kërkohej të transferonin minimalisht pesë përqind të të ardhurave neto vjetore, siç paraqitet në pasqyrat financiare, në rezerva ligjore, derisa kjo rezervë të barazonte një të dhjetën e kapitalit të nënshkruar dhe kjo rezervë nuk mund të shpërndahej. Më 14 prill 2008 në Shqipëri hyri në fuqi një ligj i ri për shoqëritë tregtare, i cili nuk kërkon që shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar të njohin ndonjë rezervë për qëllime ligjore. Përdorimi i këtyre rezervave ligjore është në vullnetin e ortakëve.

19. Rezerva të tjera

Përpara 2012, Ortakët e Shoqërisë në mënyrë unanime kanë aprovuar transferimin e 5% të fitimit neto të çdo viti, në rezerva të tjera. Përdorimi i këtyre rezervave të tjera është në vullnetin e ortakëve.

20. Detyrime ndaj palëve të lidhura

Detyrimi ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhet si vijon:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
SIBEG Srl	1,537,713	-
Uji i Ftohte Tepelenë Shpk	2,366,308	6,500,442
ACIES	9,692,566	13,285,360
Crilu Shpk	655,104	773,636
	<u>14,251,691</u>	<u>20,559,438</u>

21. Detyrime ndaj furnitorëve

Detyrimet ndaj furnitorëve më 31 dhjetor 2018 dhe 2017 përbëhen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2018</u>	<u>31 dhjetor 2017</u>
Të huaj		
Materiale të para	95,425,822	103,339,289
Të tjera	20,912,074	18,137,618
Vendas		
Materiale të para	1,816,471	7,336,092
Të tjera	27,829,300	53,430,835
	<u>145,983,667</u>	<u>182,243,834</u>

Më 31 dhjetor 2018, detyrimet ndaj furnitorëve të huaj për materiale të para përbëhen kryesisht nga European Refreshments Southgate (koncentrati) në shumën prej 42,523,223 Lek, Antei International SA dhe Pfeifer Langen Polska (sheqer) në shumën 12,033,450 Lek dhe 4,941,737 Lek, Crown Hellas Can dhe Ball Beverage Packaging Europe Ltd (kanaçe bosh) në shumën 14,123,848 Lek dhe 3,020,519 Lek, Koksan (preforma) në shumën 13,223,078 Lek dhe Bericap (kapsula PET) në shumën 3,092,535 Lek. Detyrimet ndaj furnitorëve vendas për materiale të para përbëhen kryesisht nga Messer AlbaGaz (CO₂) në shumën 882,423 Lek dhe Edipack (film) në shumën 400,238 Lek. Në 2018, Shoqëria ka fshirë detyrime ndaj furnitorëve në shumën prej 3 milion Lek.

